



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 06.08.2018,  
e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Milazim Vitija (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejtë (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Sokol Berisha (AAK), Ylli Bogaj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

Munguan: Uran Ismaili (PDK), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Florida Canolli (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

**Halim Halimi** tha se, ne si GP i LDK-së kemi pritur që në këtë mbledhje ta kemi edhe Raportin financiar gjashtëmuajor, si dhe Raportin e auditimit, po ashtu kemi menduar që do të funksionalizohen komitetet e Kuvendit. Unë këtë e shoh si një neglizhencë të madhe të kryesuesit të Kuvendit, bashkë me kryetarin, si dhe e shoh se në rendin e ditës as për sot, as për nesër nuk ka ardhur pika për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për shfrytëzimin e pronave të paluajtshme të Komunës.

**Sami Boroci**, propozoi që pika e pestë e rendit të ditës "Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës", të shtyhet për një seancë tjetër, duke e formuar edhe një grup punues, me arsyetimin se Shoqata e Gastronomëve ka dhënë disa komente, ku ata kanë kërkuar që orari të zgjatet, veçanërisht në zonën dimërore, deri në orën 12:00.

**Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, tha se këtë çështje e kemi diskutuar që një kohë të gjatë dhe e kemi një problem, me të cilin duhet të ballafaqohemi edhe si Kuvend komunal, edhe si ekzekutiv. Pajtohem që ndoshta duhet me e bërë shtyrjen e kësaj pike, sepse, realisht, nuk është problemi as i orarit të punës deri në orën 12:00, dimrit apo verës, sepse edhe sot e kanë orarin e punës deri në orën 11:00, por shumica e këtyre lokaleve fillojnë punën nga ora 10:30, dhe asnjëri prej tyre nuk mbyllt as në 11:00, as në 12:00.

*Egzon Azemi propozoi që të mbahet një minutë heshtje për nder të jetës dhe veprës së veprimitarit Adem Demaci.*

**Eman Rahmani** bëri vërejtje në pikën e dytë të rendit të ditës, që kishte të bënte me bartjen e buxhetit të pashpenzuar, duke thënë se nuk na është ofruar asnje material shtesë, për të parë se cilat mjete janë për t'u bartur në buxhet. Ai kërkoi nga drejtoresha, apo kompetencë e kujt është, që t'u dërgohet këshilltarëve një material i hollësishëm në lidhje me atë se si do të barten ato mjete, cilat projekte kanë mbetur në buxhet, prej cilave projekte ka mbetur kjo bartje dhe si po paguhën tash e shtatë muaj ato projekte, disa prej të cilave janë duke u punuar e disa kanë përfunduar.

**Agim Gashi** theksoi se për pikën e dytë të rendit të ditës "Bartja e buxhetit...", mungon materiali, mungojnë lista e prioriteteve, andaj kjo pikë duhet të shtyhet, nuk mund të shqyrtohet, sepse nuk e dimë cilat prioritet janë propozuar.

**Shefki Gashi** tha se shefat e GP të subjekteve politike kanë marrë një kërkësë nga banorët e lagjes "Kullaj", të cilët kërkojnë rregullimin e rrugës, e cila është në gjendje të mjerueshme, andaj propozoi që të jetë në prioritet projektin për këtë rrugë.

**Fikneta Bejta** bëri pyetje se si mund të sillet një raport finanziar për gjashtëmuajor, ku asnjë rresht në atë raport nuk specifikohet a janë shprehur bartjet e vitit 2017, pastaj si mund të vazhdojmë tutje nëse nuk e kemi debatuar edhe Raportin e auditimit, i cili, mendoj se ata që kanë ndonjë logjikë profesionale financiare, duhet të janë të shqetësuar me të gjeturat e atij reporti.

**Egzon Azemi** kërkoi nga kryetari që t'i propozojë tre emra për anëtarë të Komisionit për vlerësimin e pronës së paluajtshme

**Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, tha se sa i përket shtyrjes së pikës së dytë për ndonjëren nga seancat e radhës, materialin e kemi gati, por vetëm presim të shohim për nënshkrimin me Pallatin e Rinisë, sepse Qeveria e ka vonuar nënshkrimin e kalimit të Pallatit të Rinisë. Si të kalojë ky nënshkrim, dëshirojmë që të kemi një marrëveshje me kreditorët, me ata të cilëve Pallati i Rinisë u ka borxh, për shkak të një vendimi të gjykatës, me ç'rast do të mund të planifikonim më mirë buxhetin.

Sa i përket Raportit të auditimit, mund të them se ka qenë një prej raporteve me më së paku vërejtje.

Ai propozoi që pika e dytë dhe e pestë të hiqen nga rendi i ditës.

**Valbona Petrovci** tha se Komiteti për komunitete, anëtare e të cilit jam, është duke funksionuar me rregull. Po ashtu, ceku se më 9.8.2018, është caktuar mbledhja e parë e konstituimit të Komitetit për Arsim, Shkencë e Kulturë.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, me propozimet që u dhanë për heqjen e pikës së dytë nga rendi i ditës "Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018", dhe pikës së pestë "Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës", si dhe propozimi që në rend të ditës të futet pika: "Propozimvendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim".

**Kryesuesi konstataoi se më 22 vota për, u miratua ky**

#### **REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokrri";
3. Propozimrregullore për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
4. Propozimrregullore për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
5. Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës;
6. Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës;
7. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
8. Propozimvendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

**Pika e parë.**

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**Kryesuesi konstataoi se më 34 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Pika e dytë.**

**Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokrri".**

**Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës**, tha se ne kemi propozuar që për nder të ditëlindjes së Fadil Vokrrit, stadiumi i qytetit të Prishtinës të emërtohet me emrin "Fadil Vokri".

**Kryesuesi konstatoi se me 40 vota për, u miratua Vendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokri".**

### Pika e tretë

#### **Propozimrregullorja për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.**

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

Lidhur me këtë propozimrregullore, **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, i njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra.

**Fiknete Bejta** bëri vërejtje në nenin 17, e cila tha se kam kërkuar që këtij nenit t'i shtohet një pikë e re dhe të thuhet, të specifikohet: "vëtëm për gratë dhe vajzat e reja që duan të krijojnë biznese ose startape". Po ashtu, te monitorimi, si do të funksionojë ky monitorim, a do të ketë një komision, apo do të kenë departamente specifike për këto.

**Shefki Gashi** tha se ky buxhet që përcaktohet për subvencione dhe për grante, pse nuk menaxhohet nga drejtoritë përkatëse? Po ashtu, në këtë rregullore nuk është definuar edhe konflikti i interesit, se ne si asamblistë kemi apo jo të drejtë të marrim subvencione.

**Agim Gashi** theksoi se nenet 14 dhe 15 nuk janë në përputhshmëri, e që kanë të bëjnë me kriteret që parashihen për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë.

**Genc Sherifi** u shpreh se te subvencionet për bujqësi, shihet se nuk është paraparë edhe për blektori, apo ndoshta është harruar, andaj do të duhej të shtohej si kategori në nenin 19.

**Eman Rahmani** shprehu mendimin lidhur me nenin 7 dhe nenin 9, e që nuk do të duhej të ishin në përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës emërimi i Komisionit të ankesave dhe Komisionit për vlerësimin e ankesave. Njëra prej tyre do të duhej t'i delegohet Kuvendit, për të pasur një mbikëqyrje sa më të mirë.

**Egzon Azemi** bëri vërejtje në nenin 7 dhe nenin 9, duke thënë se do të ishte mirë që Komisioni për ankesa të ketë një përfaqësues nga Kuvendi i Komunës. Kjo në njëfarë forme tregon nëse ka pasur parregullsi gjatë dhënies së subvencioneve ose jo, kështu që ose le të jenë 2 anëtarë të Kuvendit të Komunës edhe te Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave, ose le të jetë një nga Kuvendi dhe një përfaqësues i Shoqërisë civile.

**Vala Peshku** vërejte bëri në nenin 7, pika 7.5 dhe në nenin 9, pika 9.4, duke thënë se këto nene duhet të specifikohen më mirë.

**Leonora Shabani-Bajraktari** kërkoi të dijë se çka ofron kjo rregullore për fëmijët me nevoja të veçanta, kur flasim për shkollat fillore. Do të duhej të parashihej që të kishin të drejtë që edhe shkollat, drejtori i shkollës, apo financieri i shkollës me aplikuar për të pasur një fond më të mirë, për të pasur një ngritje të cilësisë në arsim.

**Blerand Stavileci** shprehu mendimin se në preambulë të kësaj rregulloreje do duhej të përfshihej edhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, sepse në nenin 11, paragrafi 2 e precizon shumë mirë këtë çështje. Po ashtu, do të ishte mirë që të gjendej një formulë që në Komisionin e ankesave të jetë një përfaqësues nga Kuvendi i Komunës.

**Vlora Dumoshi** tha se kjo rregullore ka qenë shumë e nevojshme, sepse ka munguar një rregullore e tillë, por shqetësimi im kryesisht ka të bëjë me pjesën e kulturës, duke parë se në mandatin e kaluar zakonisht në komisione janë emëruar njerëz të cilët kanë pasur organizata të tyre, kanë pasur festivalë të ndryshme dhe kanë qenë përfitues.

Po ashtu, sugjeroj që në mes të Komunës dhe Ministrisë së Kulturës të jetë një bashkëpunim sa më i mirë, sepse subvencionet në komuna janë të pakta e kërkesat janë të mëdha.

**Nol Nushi** nuk u pajtua me diskutimet e disa parafolësve lidhur me përbërjen e komisioneve, duke thënë se Kuvendi i Komunës nuk ka kompetencë që t'i caktojë orientimin Kryetarit të Komunës se nga dëshiron ai t'i orientojë paratë e Komunës, përderisa ai është zyrtari kryesor i Komunës.

**Visare Gashi-Gorani** tha se kjo rregullore në disa nene ka mangësi, në aspektin gjuhësor dhe në përmbajtje. Ajo sugjeroi që në nenin 1, pika 1, në fund të fjalisë të shtohet: "... për persona fizikë dhe juridikë, duke respektuar parimet e barazisë gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore". Vërejtje pati në nenin 9, pika 2, në nenin 24, dhe në nenin 26.1, pika c, andaj kërkoi që këto nene të korrigohen dhe të specifikohen më mirë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë **Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, dhe **Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore.

**Kryesuesi** e hodhi në votim Propozimrregulloren për ndarjen e subvacioneve në komunën e Prishtinës.

**Kryesuesi** konstatoi se më 26 vota për, u miratua Rregullorja për ndarjen e subvacioneve në komunën e Prishtinës.

#### **Pika e katërt**

**Propozimrregullorja** për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave, për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

**Kryesuesi** konstatoi se më 34 vota për, u miratua Rregullorja për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave, për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

#### **Pika e pestë dhe e gjashtë**

**Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës** dhe **Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës**.

Lidhur me Projektstatutin e Muzeut të Prishtinës dhe Projektstatutin e Qendrës Kulturore të Prishtinës, **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, tha se meqë po mungon drejtori i Drejtorisë së Kulturës dhe meqë po kërkohet ideatori, ku ideatori i kësaj është z. Yll Rugova, drejtor i Kulturës, propozoj që këto dy pika të shtyhen për diskutim në njëren nga mbledhjet e radhës.

**Kryesuesi konstatoi se Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës dhe Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës, shtyhen për diskutim për në njëren nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ.**

**Halim Halimi:** Në emër të GP të LDK-së, për anëtar të panelit për Komitetin konsultativ propozoi znj. Vlora Dumoshi.

**Besnik Mujeci,** në emër të GP të LVV-së, për anëtar të panelit për Komitetin konsultativ propozoi z. Mirsad Vitia.

**Kryesuesi:** Sami Boroci, në emër ttë GP të AKR-së dhe të koalicionit, për anëtarë të panelit për Komitetin konsultativ propozoi z. Vesel Makolli dhe z. Fadil Gashi.

**Migjen Shala,** në emër të GP të PDK- së, për anëtar të panelit për Komitetin konsultativ propozoi z. Leutrim Retkoceri.

**Fadil Gashi,** në emër të GP të AAK-së, për anëtar të panelit për Komitetin konsultativ propozoi znj. Suzan Kika.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna nga subjektet politike.

**Kryesuesi konstatoi se për anëtarë të panelit për Komitetin konsultativ, nga Kuvendi caktohen: Mirsad Vitia, më 20 vota për, Vesel Makolli, më 21 vota dhe Suzan Kika, më 22 vota për.**

Për anëtarë të panelit për Komitetin konsultativ nga ekzekutivi dhe nga Shoqëria civile, u propozuan: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, dhe Albulena Nrecaj, përfaqësuese nga Shoqëria civile.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 11 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.**

**Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Halim Halimi,** në emër të GP të LDK-së, për anëtar të Komisionit vlerësues propozoi z. Shefki Gashi.

**Egzon Azemi,** në emër të GP të LVV-së, për anëtar të Komisionit vlerësues propozoi z. Besnik Mujeci.

**Vala Peshku**, në emër të GP të PSD-së, për anëtar të Komisionit vlerësues propozoi z. Bashkim Beha.

**Leutrim Retkoceri**, në emër të GP të PDK-së, për anëtar të Komisionit vlerësues propozoi z. Migjen Shala.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna nga subjektet politike.

**Kryesuesi konstatoi se për anëtarë të Komisinit vlerësues nga Kuvendi caktohen: Migjen Shala, më 30 vota për, Bashkim Beha, më 20 vota për dhe Shefki Gashi, më 17 vota për.**

**Osman Bllaca**, përfaqësues nga ekzekutivi, tha se për anëtarë të Komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, propozohen:  
Muhedin Nushi, nënkyrytar i Komunës; Genc Bashota, drejtor i Zhvillimit dhe Planifikimit të Qëndrueshëm; Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Allen Meta, nga Shoqëria civile.

*Në mungesë të kuorumin, mbledhja u ndërpresa në orën 15:10.*

Vazhdimi i mbledhjes së gjashtë të Kuvendit, më 07.08.2018.

Kryesuesi konstatoi kuorumin dhe propozoi që mbledhja të fillojë.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendimin për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

Kryesuesi konstatoi se me propozimet e dhëna për anëtar të Komisionit, më 22 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për formimin e Komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

Pika e nëntë

Pyetje dhe përgjigje.

**Rifat Deri**, për drejtoreshën e Drejtorisë së Finacave: Prej gjashtë pyetjeve që i kam dërguar herën e fundit, diku më se 15 ditë para seancës, përgjigje kam marrë vetëm nga Drejtoria e Financave, andaj kërkoj nga ekzekutivi që përgjigjet të mi jepni me kohë.

Kamë dashur një sqarim nga Drejtoria e Financave, pse duhet për regjistrimin e veturës qytetarët e Prishtinës t'i paguajnë dhjetë euro dhe pse kushtëzohet me pagesën e tatimit në pronë.

Nëse shkojmë në këtë mënyrë, mendoj se po i destimulojmë njerëzit të cilët nuk e paguajnë tatimin në pronë, mirëpo prapë duhet me e paguar këtë shumën prej dhjetë eurove.

Unë konsideroj që këta që e kanë paguar tatimin në pronë dhe e kanë tatimin zero, duhet me u liruar prej kësaj takse dhjetë euro, kurse ata që nuk i kanë paguar, ata duhet me i detyrua me paguar këtë taksë, sepse po bëhet destimulimi i këtyre që po e paguajnë tatimin në pronë. **Valbona Makolli**, drejtoresh e Drejtorisë së Financave, tha se duke u bazuar në Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, që është aprovuar në këtë Kuvend, kemi konstatuar se ajo tarifë nuk është dënim, por është një tarifë sipas rregullores në fuqi. Mirëpo pse kërkohet vërtetimi në pronë, është vetëm kushtëzim jo vetëm për këtë pagesë, por edhe për kopje të planit apo çfarëdo shërbimi që kryhet në Komunë.

**Rifat Deri** tha se prapë nuk pajtohem edhe me këtë rregullore dhe propozoi që Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale të sillet në Kuvend për ndryshimin e saj.

**Migjen Shala, për Kryetarin e Komunës:** Kërkoi përgjigje nga kryetari lidhur me këtë pyetje. Pse sheshi "Adem Jashari" nuk e ka asnë element të UÇK-së dhe tash me promovimin e këtij sheshi, nuk është vendosur shtatorja e Adem Jasharit?

**Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, tha se Adem Jashari meriton një vend, po e quaj ndoshta më të mirin në kryeqytetin e Kosovës, dhe po bëhen 19 vjet pas përfundimit të luftës që mos të kemi shtatore, vërtet është shumë keq. Unë nuk kam qenë pjesë e Komunës kur i është dhënë emri sheshit "Adem Jashari", nuk i di as arsyet pse është bërë atëherë ai emërtim. Ky shesh ka qenë në gjendje shumë të keqe, pra ne kemi bërë sanim të dyshemesë. Sa i përket përmendores e cila është aty, historia tregohet edhe përmes arkitekturës, edhe ajo përmendore mendoj se duhet të mbetet aty.

#### **Leutrim Retkoceri, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:**

- Në rrugën "Bajram Curri", në lagjen "Arbëria", është një mur që është në rrezik për t'u shembur dhe paraqet rrezik për fëmijë, andaj prindërit e tyre janë të shqetësuar dhe kërkojnë që të merren masa për sanimin e atij muri.
- Në rrugën "Bill Clinton" në Prishtinë, çdo pasdite kemi një ngarkesë të madhe të takrive, që rrinë anash në trasenë në të djathhtë që shkon në drejtim të Katedrales dhe kjo trase thuajse është e pakalueshme.
- Banoret e lagjeve, sidomos të lagjeve "Ulpiana" dhe "Dardania", nuk gjejnë asnë parking të vetëm afér lagjes ose në parkingjet e atyre banesave ku janë aty për parkimin e veturave të tyre. A ka ndërmarrë ndonjë masë Inspeksioni, apo drejtoria përkatëse me ju siguruar këtyre banorëve parkingje edhe me i mirëmbajtur ato?

**Kumrie Shabani, për drejtorin e Drejtorinë së Arsimit:** Një grup qytetarësh të Prishtinës kërkojnë që të formohet një grapi ekspertësh të ndihmës së parë, për trajnimin e mësimdhënësve nëpër shkolla fillore dhe të mesme, lidhur me re- animimin kardiopolmular, pasi që në një shkollë të Prishtinës para disa muajve ka ndodhur një vdekje e pa pritur nga sulmi kardiak dhe mos ofrimi i ndihmës së parë nga stafi i shkollës, mësimdhënësja ka përfunduar me fatalitet. Në shkolla të Prishtinës mungon stafi mjekësor, ku një trajnim i tillë është shumë i mirëseardhur.

**Jonus Salihaj**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se ky ka qenë rast i rëndë, por pajtohem që nëpër shkollat tona duhet pasur edhe lëndë që e trajtojnë këtë problem, si p.sh. në kuadër të biologjisë, në kuadër të edukatës qytetare dhe në kuadër të mësimit me zgjedhje. Në shkollat tona ka shumë lëndë me zgjedhje dhe obligative që e trajtojnë këtë temë, dhe sigurisht që duhet me i dhënë rëndësi më të madhe për shkak të pasojave që mund ti kenë.

**Adrian Berisha**, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave:

- Një anëtar i ansambleve të qytetit të Prishtinës, me anë të një kërkese ka shprehur shqetësimin e tije për mos ndarjen e subvencioneve dhe besoj se është një shkelje flagrante e të drejtave të ansambleve të qytetit tonë që mos me iu ndarë asnjë cent këtyre ansambleve.
- Shqetësim tjetër i qytetarëve të lagjes "Veterniku", është dëmtimi i rrugëve nga kompanitë e ndryshme, si: KEDS, Rezonanca, etje. të cilat po lihen në gjendje të mjerueshme.

Çka duhet me bërë ne si Kuvend apo si Komunë, me e krijuar një rregullore, sipas së cilës do të obligoheshin këto kompani private që rrugën me e kthyer në gjendjen e mëparshme?

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sipas një analize që e kemi bërë, kompanitë publike dhe private bëjnë kërkese në Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, ku ne në formë të shkruar e përpilojmë një vendim dhe ia japim për kërkesat e tyre. Në vendimin që e lëshon drejtoria, aty parashihen më se tridhjetë e gjashtë kritere, që duhet të nënshkruhen nga kompania e cila e ka formën ligjore. Sa i përket respektit dhe obligimit të tyre, ata në këtë moment nuk po dalin karshi obligimeve që i kanë. Më se 80 - 90% të gropave në Komunën e Prishtinës tash për tash po na i shkaktojnë këto kompani.

**Fadil Gashi**, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Kërkoi nga kjo drejtori që të marrë masa në sanimin e gropave në lagjen "Kodra e Diellit", ku aty vërtet qe dhjetë vjet ato rrugë nuk janë mbushur me asfalt.

**Vala Peshku**, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Rruga "Ramiz Cërnica" në lagjen "Përroi i Njelmët" është në gjendje shumë të keqe, andaj ka kërkesa nga qytetarët që së paku ajo rrugë të sanohet në njëfarë mënyre, derisa të bëhet një zgjidhje tjetër.

**Sami Boroci** tha se sa i përket sheshit "Adem Jashari", kur është diskutuar paraprakisht kjo temë, unë pata propozuar një hapësirë tjetër, që hapësira nga hoteli "Grand" deri te katedralja të shndërrohet në shesh.

Andaj, propozoj që pikërisht kjo hapësirë, nëse është paraparë një plan i tillë, ky shesh të emërtohet sheshi "Adem Jashari" ku do të duhej të ishte edhe shtatorja e heroit tonë. Sa i përket statujës, unë nuk kam ndonjë koment, por duke u bazuar në aspektin historik edhe mund të qëndrojë. Unë pajtohem se është paradoks me e mbajtur emrin Adem Jashari dhe të qëndrojë aty një statujë e tillë.

**Visare Gorani- Gashi**, lidhur me përmendores në sheshin "Adem Jashari", tha se përmendoret janë pjesë e kujtesës kolektive, të cilën e ceku edhe kryetari, se në shumicën e vendeve të ish-bllokut komunist ekziston arkitekturë, ekzistojnë përmendore edhe monumente që na e përkujtojnë të kaluarën.

Sa i përket përmendores së Adem Jasharit, kisha propozuar që të gjithë së bashku të jasin propozimin se ku të vendoset dhe të kemi një konsensus, një mendim të përbashkët për një familje dhe një person, i cili sakrifikoi bashkë me familje për të sotmen tonë.

**Egzon Azemi**, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Çka është duke ndodhur me shkallët në lagjen "Arbëria", për të cilat mund të thuhet se janë në gjendje të mjerueshme?
- Është premtuar nga drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, se ka për ta vendosur flamurin te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti, por një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur!

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se për shkallët në lagjen "Arbëria" është paraparë projekti, i cili zgjat 120 ditë pune deri në përfundimin e tij. Tani është dita e 54-të e punës, por ka pasur shumë ndërprerje për shkak të reshjeve atmosferike. Firma e cila po i kryen punët është sipas planit dinamik në kuadër të Komunës.

Sa i përket çështjes së rrethojave të varrezave në Viti të Marecit, këtë projekt e kemi dërguar në prokurim dhe ka mbetur që të kryhen fazat tenderuese dhe në momentin kur përfundon faza tenderuese, ne fillojmë menjëherë me renovimin e tyre.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, për Kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, për drejtorin e Drejtorisë së Administratës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Për çfarë arsy është anuluar konkursi i drejtorëve, për shkak se një kohë të gjatë është zvarritur ai konkurs dhe më pas është anuluar, do të thotë kjo procedurë ka zgjatur 2-3 muaj?
- Për lagjen e Medresesë është premtuar që të rregullohet rrjeti i kanalizimit për ujërat e zeza, por ende nuk ka filluar asnje punë të bëhet në atë pjesë.
- Kur do të fillojnë punimet për Tregun e gjelbër, që parashihet të ndërtohet në pjesën ku gjendet AKP-ja?

- Për vitin 2018, është premtuar se do të filloj ndërtimi i Qendrës Sindrom Daun dhe Autizëm, por nuk ka filluar ende.
- Personeli që bën punën e sigurimit në objektin e Komunës, është ankuar se tash e dy muaj nuk kanë marrë paga. A është ndërmarrë ndonjë masë sa i përket kësaj çështjeje?
- Pse u largua parkingu për personat me aftësi të kufizuar në lagjen "Ulpiana" D1/4.? **Selim Pacolli**, nënkyrytar i Komunës, tha se ndërtimi i objektit për Sindrom Daun besoj se shumë shpejt do të fillojë. Ne presim që me parashikimin e buxhetit, të ndahet një vijë buxhetore për financimin e këtij projekti.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se ujërat e zeza në këtë lagje janë një problem shumë i madh. I kemi diku rrëth 350 kilometra kanalizim në tërësi. Sipas një analize që e kemi bërë, ne duhet ndërruar 200 kilometra kanalizim për me e rregulluar situatën e ujërave të zeza në komunën e Prishtinës. **Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se pjesa ku është ky treg, në bazë të Plan rregullues parashihet të jetë zonë historike. Ne e kemi hapur një konkurs vitin e kaluar, ka fituar një projektide për një çarshi të vjetër, ku do të integrohej edhe Tregu i gjelbër.

Është akute kjo çështje, besoj se do të investojmë ne, ka qenë ideja ose Komuna me investuar vetë, ose me partneritet publiko - privat, por si duket investimi nuk është i madh dhe kryetari është i mendimit që këtë investim ta bëjë Komuna.

**Ismail Kokaj**, drjtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se sa i përket parkingut, për këtë çështje jemi sqaruar dje, por nëse personi ka pasur ankesë, keni mundur t'ia kërkoni dokumentacionin se si ka ndodhur deri tek largimi i lejes.

**Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se për shkak të procedurave administrative, vonesave në tender, punëtorët e sigurimit të objektit të Komunës për dy muajt e fundit nuk i kanë marrë rrogat, por jemi shumë afër zgjidhjes së kësaj çështjeje. Faktikisht, mund të them se gati është zgjidhur situata komplet me krejt punëtorët dhe së shpejti do t'i marrin të dy pagat nga kompania, d.m.th. ka qenë çështja në ankesa të tenderimit.

**Eman Rrahmani**, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për Kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- Deponitë ilegale të mbeturinave janë bërë një fenomen i jashtëzakonshëm. Inspeksioni as nuk është duke i dënuar ata që po hedhin mbeturinat. Vetëm në lagjen "Kodrën e Trimave" janë diku 4-5 deponi, ku me dhjetëra kamionë bartën mbeturinat në atë pjesë. Unë kam bërë kërkesë edhe më herët, i kam informacionet, mirëpo askush nuk është duke ndërmarrë asnjë masë, pra është gjendje jashtëzakonisht shqetësuese. Veprime të tillë ka pasur edhe më herët, por nuk ka qenë në këtë gjendje që është tash.
- Po ashtu, një deponi në pjesën ku tash është tenderuar me u bërë parku në lagjen "Arbëria", ku në ditë hedhen deri 50 kamionë me mbeturina.

- Cilat rrugë janë në tender për pastrim me ujë dhe cilat kompani e kanë fituar tenderin?
- Afër objektit të Komunës, është një pjesë e Komunës ku shfrytëzohet ilegalisht nga një kompani e parkingut. Pse nuk lirohet ajo hapësirë, të paktën mundet me iu dhënë ndonjë familjeje me çështje sociale me e shfrytëzuar për parking sa e përdor ajo kompani ilegalisht?

**Agim Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Sa leje ndërtimore janë dhënë në zonën e mbrojtur të Gërmisë, parkut "Gërmia"? - Pjetje kjo që e kam bërë disa herë dhe nuk kam marrë përgjigje asnjëherë.
- Janë dhënë apo nuk janë dhënë leje për ndërtim në zonën e mbrojtur? Nëse një është dhënë, ta dimë cila është dhënë, sepse gjashtë vjet është propaganduar se janë ndalu ndërtimet pa leje.
- Pse nuk po pengohet hedhja e mbeturinave në pjesën periferike të Prishtinës, konkretisht në fshatin Mramur, Kodrat e Hajvalisë e në vende të tjera.
- Pse Komuna dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk gjejnë fuqi ta rregullojnë çështjen e pranimit të zjarrfikësve, dhe kur do të lind ai vullnet për rregullimin e këtij problemi, meqenëse kemi të bëjmë me emergjencat, sepse emergjencat janë fushë shumë e rëndësishme?
- Pse nuk është bërë shtrirja e kanalizimit edhe në pjesët tjera për pastrimin e ujërave të zeza, por vetëm në fshatin Mramor, ku sipas marrëveshjes ka qenë e planifikuar që të përfshihen edhe pjesët tjera rurale?
- Në cilën fazë janë zhvillimet e bisedimeve për ndërtimin e shkollave, cilat janë ato pikat e ndërtimit të shkollave dhe cili është donacioni për ato projekte?

**Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Banorët e fshatrave Besi, Prugovc, Barilevë dhe Vranidoll, kërkojnë urgjentisht vendosjenet e një semafor në fshatin Besi.
- Pse nuk janë në projekt për dizefektim fshatrat Trudë, Lebanë, Prugoc dhe Rimanishtë?
- Banorët e lagjes "Pejton" janë të rrezikuar nga qentë endacakë, kryesisht afër Radio Kosovës, edhe pse ata shihen qe janë të trajtuar. Po ashtu, edhe banorët e fshatit Besi dhe Rimanishtë janë të rrezikuar nga qentë endacakë.
- Ruga për në fshatin Rimanishtë, është pak urgjente rregullimi i kësaj rruge, e cila të shkon në drejtim të shtëpisë së ish-kryetarit të Komunës, Nazmi Mustafa, është në gjendje katastrofale, e kom cekur shumë mirë që ka pacientë aty. Po ashtu, edhe në fshatin Besi një segment i rrugës prej 100 metrash, është më se e domosdoshme sanimi i asaj rruge.

**Ismail Koka**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se trajtimi i qenve endacakë ka vazhduar, mirëpo problematika është se për çështjen se a është i tërbuar qeni apo jo, e vendos eksperti i veteranës në këtë rast.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projekteve të rrugëve, ne duhet t'i zbatojmë ato kontrata që janë për ato rrugë, sepse nuk kemi të drejtë ligjore që të caktoj prioritete jashtë kontratës.

**Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët e lagjes "Përroi i Njelmët" kanë paraqitur shqetësimin e tyre lidhur me infrastrukturën rrugore dhe atë përcjellëse, që është në gjendje të mjerueshme, ku nga drejtori është premtuar se në muajin qershor do të ndërmerren disa masa, por këtu nuk ka ndërmarr asnjë masë.
- Disa kërkesa prej banorëve të lagjes "Tophane", lidhur me bllokimin e ujëmbledhësit, si pasojë e punimeve që bëjnë në atë lagje kompanitë punuese të ndërtuesave të larta, ku ata e bëjnë pastrimin e atyre betonierëve, ku pastaj po formohen shtresa betoni brenda sistemit të kanalizimit, duke bërë bllokimin e kanalizimit. Po ashtu, kjo po ndodh edhe në rrugën "Çajupi", që nis nga rruga "Lidhja e Prizrenit", gjithashtu mungesë e infrastrukturës rrugore dhe përcjellëse.
- Gjendja e rrugës që lidh lagjen "Arbëria" me lagjen "Kodra e Trimave", është një ngushticë e cila qëndron më tepër se gjashtë muaj e hapur, por nuk është mbyllur ende dhe është në gjendje shumë të keqe.
- Për këndet e lojërage në lagjet "Arbëria" dhe "Qafa", fatkeqësisht, nuk po duket se po përkujdeset askush, me sa e di, janë edhe 49 fusha të futbollit, basketbollit, në qytetin tonë, por terrenet sportive nuk po mirëmbahen.

**Ismail Koka**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se sa i përket ujëmbledhësve, është e vërtet se ka pasur shumë të reshura sivjet edhe kemi pasur bllokimin e ujë mbledhësve, përndryshe çdo ditë jemi në aksion në pastrimin e tyre.

**Mustafë Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Banorët afër rrugës "Luigj Gurakuqi", konkretisht mbrapa rezervuarëve të ujit në lagjen "Velania", diku një segment rrugor rrëth dyzet metra, aty është dëmtuar kanalizimi dhe ujërat fekale dalin përmbi, andaj kërkohet urgjentisht rregullimi i saj. Kërkoi që të merren masa për rregullimin e atij kanalizimi.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se ne do të dërgojmë një ekip punues që të njihet më konkretisht për gjendjen ekzistuese, mirëpo kompetent për këtë çështje është Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**Shefki Gashi** kërkoi nga drejtori, z. Gëzim Mehmeti, që t'i vazhdojë ato projekte të cilat i ka filluar me fillimin e këtij mandati.

Sa i përket caktimit të sheshit "Adem Jashari", tha se sheshi është caktuar nga Qeveria e Përkoħshme e Komunës së Prishtinës, në vitin 1999. Edhe projekti i LDK-së ka qenë që aty tē parashihet me u ndërtuar parking nëntokësor, por kur kanë filluar punët, është rrezikuar të shembej trekëndëshi dhe janë ndalur punimet, kështu që përkohësisht janë ndërprerë punimet derisa t'i caktohet sheshit një vend tjetër.

**Jeta Rafuna – Hasani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për nënkyrytarin e Komunës:**

- Banorët, kryesisht të rinjtë e lagjes "Taslixhe" në Taukbahçe, kérkojnë që aty ku është fusha e tenisit, të vendosen edhe kosha të basketit, nëse ka mundësi, në mënyrë që të shfrytëzohen pak më shumë ato fushat sportive.
- Kur planifikohet të ketë linjë të autobusit në lagjen "Prishtina e Re", prapa Pallatit të Drejtësisë, si dhe në rrugën "Xhavit Ahmeti", ish-rruga "Bledi", që lidhet lart me lagjen "Vreshtat" apo me "Kolovicën e Re"?
- A ka mundësi që të vendosen shtyllat antiparking në rrugët: "Haxhi Zeka", "Varoshi" dhe "Nazim Gafurri", sepse është e pamundur ecja nëpër trotuare nga parkingu i veturave?

**Ismail Kokaj**, drjtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se ne jemi çdo ditë duke e rritur numrin e shtyllave antiparking, me mundësi që do të arrijmë edhe në ato vende ku urgjent po kérkohet vendosja e tyre.

**Besnik Mujeci, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- A është marrë parasysh peticioni i Lagjes së Muhaxhirëve për rregullimin e Parkut të Qytetit?
- Pse nuk janë rregulluar rrugicat në fshatin Vranidoll, fshati i vetëm që është anashkaluar, që ka qenë zotim i fushatës, ku janë të kryera të gjitha procedurat dhe skicimet dhe nuk ka shkuar fare në tenderim?

**Vlora Dumoshi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

- Kérkoj nga drejtoria përkatëse që të investohet në hapësirat të cilat janë të ndërtuara me fusha sportive në komunën e Prishtinës, kryesisht të pajisen me kosha të basketit, për të luajtur fëmijët apo të rinjtë.

**Milazim Vitija, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Pse nuk po kryhen shërbimet për mbledhjen e mbeturinave në fshatrat e Malësisë së Gollakut, kur dihet se tashmë ka filluar faturimi i mbeturinave në këto fshatra?
- **Ismail Kokaj**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se është viti i parë që ka filluar një plani i ri të zbatohet, ku kemi dhe ankesa, për të cilat shqyrtohet secila ankesë veç e veç. Kjo gjendje do të vazhdojë deri në një kohë, deri në gjetjen e një rruge më të mirë, që edhe qytetarët me qenë të kënaqur me këtë shërbim.

**Fiknete Bejta, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët pranë Fushës së Pajtimit kërkojnë që të rregullohet rruga e shkatërruar dhe mundësishët të rregullohet edhe kanalizimi si pjesë të përcjellëse.
- Banorët e lagjes "Mati 1", te kompleksi "Tregtia", më 22 maj të këtij viti, kanë kërkuar shpimin e një pusi, me qëllim të mirëmbajtjes ose ujitjes së kopshtit dhe ambienteve të tyre.

**Ismail Koka**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se sa i përket hapjes së puseve, ato caktohen gjatë planifikimit të buxhetit, pra do të ishte mirë që ata banorë kur të bëhen dëgjimet publike, të bëjnë kërkesë që të parashihet në planifikim të buxhetit.

**Egzon Azemi, për Kryetarin e Komunës, drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Administratës:**

- A ka pasur, apo ka mundësi që Drejtoria e Kulturës ose edhe vetë kryetari apo nënkyetari, të ndikojnë dhe të bëjnë një lloj marrëveshje të re me organizatorët e festivalit "Soni Hill", që çmimi të janë më i arsyeshëm, sepse vetë shfrytëzimi i një pjese aq të madhe dhe aq të rëndësishme të parkut "Gërmia" edhe një çmim aq i shtrenjtë, kur e dimë gjendjen ekonomike të të rinjve të Prishtinës, është shumë i paarsyeshëm?
- Çfarë po ndodh me autobusët, kur pritet të vijnë në Prishtinë?
- Banorët e Zllatarit kërkojnë që edhe ky lokalitet të mbulohet me vijen e linjës nr. 4.
- A ka mundësi që të bëhet një planifikim i ri, ku autobusët sa presin aty te xhamia në Matican, të paktën me iu shërbyer qytetarëve deri në një pikë në fshatin Zllatar?
- A është planifikuar liga shkollore për nxënësit në basketboll dhe futboll? Këtë çështje e kam ngritur edhe më herët, por deri më tash nuk kam parë që është ndërmarrë diçka.
- A është e vërtet se në Komunën e Prishtinës ndaj disa personave po bëhet presion përmes mundësive të vazhdimit të kontratave, dhe ky presion po bëhet vetëm për shkak të bindjeve politike?

**Pika e dhjetë  
Të ndryshme.**

**Rifat Deri** tha se gazeta "Ekspres" ka shkruar se unë kam votuar kundër emërtimit të stadiumit të Prishtinës "Fadil Vokrri". Ky shkrim është i pavërtetë, tendencioz, dhe tash këtë e vërtetova në kabinën ku shihet votimi, aty unë kam votuar për, kështu që gazeten "Ekspres" po e demantoj menjëherë këtu dhe nëse duan dëshmi, minden me e parë dëshminë në dhomën e regjisë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

Faqe 15 nga 15

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**